



Datë: 22.04.2026

A.nr.1962/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, më Merlinda Ramaj si procesmbajtëse, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1962/2025, të datës 01.12.2025, të parashtruar nga ankuesi, B.K, kundër organit të punësimit: Agjencia e Punësimit, në çështjen juridike “*Kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 22.04.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1962/2025 e datës 01.12.2025 e parashtruar nga ankuesi B.K.

II. Mbetet në fuqi Vendimi më numër protokolli 3054, i datës 24.10.2025, i ushtrueses së detyrës së Drejtores së Përgjithshme të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil B.K (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), përmes e-mailit të datës 27.11.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e pranuar me datë 01.12.2025 dhe regjistruar nën shenjën A.nr/1962/2025, kundër emërimit të shtrueses së detyrës së Udhëheqëses së Zyrës së Punësimit në Pejë, Agjencia e Punësimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka procedura kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës, ndërsa, kjo e fundit ka përcjell përgjigje në pretendimet ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 77621/2025 të datës 01.12.2025; Vendimin me Nr. 3054, të datës 24.10.2025 të Ushtruesit të Detyrës së Drejtoreshës së Përgjithshme të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës; Letërnjoftimin e ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë, Përgjigjen në ankesë të datë 10.12.2025; Akt emërimit të ankuesit të datës 28.12.2017; Përkrahimin e detyrave të punës; Diplomën e ankuesit të datës 30.11.2020; Diplomen e fakultetit të ankuesit me numër

787 te datës 07.06.2023; Akt emërimit të znj. B.Ll e datës 07.05.2018; Përshkrimin e detyrave të punës së znj.Ll; Diplomën e fakultetit të znj.Ll me numër 255 te datës 23.03.2016. Vendimet 217 te datës 20.11.2024, 1280, të datës 24.10.2023, si dhe emaluar komunikues në mes të KPMSHCK-se dhe AKP.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit konstatoi se ankesa **është e pabazuar, sepse:**

Gjendja e fakteve

Nga analizimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi është i punësuar në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës (tutje APRK) dhe se i njëjti ushtron pozitën Zyrtar për Shërbime të Punësimit.

Me Vendimin me numër të protokollit 3054/2025 të datës 24.10.2025, u.d Drejtoresha e Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës ka caktuar zyrtaren B.Ll ushtruese e detyrës së Udhëheqëses së Zyrës së Punësimit në Pejë.

Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pretendon se në mënyrë të përsëritur është anashkaluar në proceset e emërimit të ushtruesit të detyrës së Udhëheqësit të Zyrës së Punësimit në Pejë, pavarësisht vlerësimeve të larta dhe renditjes së performancës. Andaj, në vlerësimin e ankuesit, ky proces është i përcjell më mungesë të meritokracisë dhe transparencës, diskriminim të bazuar ndaj ankuesit, dhe konflikt të interesit, pasi që bashkëshorti i znj. B.Ll është Drejtor në Qendrën e Aftësisimit Profesional. Kërkon të rishqyrtohet procesi i emërimit të ushtruesit të detyrës së Udhëheqësit të Zyrës së Punësimit në Pejë, sqarim për kriteret e përdora më rastin e emërimit, verifikimin e konfliktit të interesit dhe marrjen e masave për garantim të barazisë dhe meritokracisë.

Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit analizoi legjislacionin e aplikueshëm në ndërlidhje me çështjen e emërimit të përkohshëm të ushtruesit të detyrës, gjegjësisht dispozitat e Ligji Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenin 35 paragrafit 1 dhe 2 ku përcaktohet se: 1. Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë. 2. Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit, dhe nenin 9 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet: 1. Paragrafi 1. i nenit 35 të ligjit bazik ndryshohet si në vijim: 1. Në rast se një pozitë e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësi i nivelit të lartë drejtues i atij institucioni e cakton me vendim ushtruesin e detyrës për pozitën e lirë. Për kategorinë e nivelit të lartë drejtues, ushtruesin e detyrës e cakton titullari”, dhe si rrjedhojë duke u bazuar në këtë kuadër ligjor, Kolegji konstaton se Vendimi me numër protokollit 3054/2025 i datës 24.10.2025, i u.d Drejtores së APRK-së lidhur me caktimin e zyrtares B.Ll si ushtruese e detyrës së Udhëheqëses së Zyrës së Punësimit në Pejë, është nxjerrë në pajtim me dispozitat ligjore si me lartë,

mbi arsyet se ankuesi sipas aktit të emërimit APRK 61, të datës 28.12.2017 dhe zyrtarja B.Ll sipas Aktit të emërimit 258/2018 të datës 07.05.2018, mbajnë pozitën Zyrtar për Shërbime të Punësimit, pra mbajnë pozitë më titull, kategori dhe klasë të njëjtë, andaj, mbi këtë fakt rezulton së me Vendimin më numër protokolli 3054/2025, të datës 24.10.2025, të u.d Drejtores e APRK-së lidhur me caktimin e ushtrueses së detyrës së Udhëheqëses së Zyrës së Punësimit në Pejë, ankuesit nuk i janë shkelur apo cenuar ndonjë e drejtë e tij, sepse, Drejtorja e Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës si person kompetent, bartë të drejtën diskrecionale të përzgjedhjes dhe caktimit të zyrtarit të caktuar në pozitën e ushtruesit të detyrës përkatëse drejtuese, më kushtin që të respektohen kërkesat ligjore sipas nenit 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Në fakt, Kolegji sjell në vëmendje faktin së sipas Regulomes (QRK) nr. 13/2015 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë e Punësimit (neni 28,) Zyra e Punësimit në Pejë është e organizuar sipas strukturës: Zyra e Udhëheqësit dhe Personeli i organit lokal, pra, njësitë rajonale të punësimit organizohet nga udhëheqësi dhe stafi profesional, e që në rastin konkret si pozitë pasuese pas pozitës së Udhëheqësit të Zyrës së Punësimit konsiderohet pozita e zyrtarëve të nivelit profesional.

Lidhur me pretendimin ankimor se me rastin e caktimit të ushtrueses së detyrës së Udhëheqëses së Zyrës së Punësimit në Pejë, nuk janë marr parasysh vlerësimet e larta të performancës së ankuesit, Kolegji rithekson së sipas nenit 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, si kriter i pa diskutuar me rastin e caktimit të ushtruesit të detyrës përkatëse është respektimi i kategorisë pasuese vartëse, ndërsa, ligji nuk ka paraparë kritere tjera ashtu siç pretendohet nga ankuesi.

Përkitazi me pretendimin ankimor për konfliktin e interesit, Kolegji bazuar vetëm në thëniet në ankesë nuk mund të vërtetoj faktin nëse një pretendim i tillë është i bazuar, pasi që pala ankuesi nuk ka ofruar asnjë lloj prove që dëshmon ekzistimin e konfliktit të interesit lidhur këtë çështje, andaj, Kolegji udhëzon palën ankuese që lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit siç potencohet në ankesë, mund të i drejtohet edhe organit kompetent, siç është Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

Bazuar si më sipër, Kolegji erdhi në përfundimin se Vendimi me Nr. 3054, i datës 24.10.2025, i Ushtruesit të Detyrës së Drejtores së APRK-së është nxjerr në pajtim më ligjin material dhe si tillë është akt i ligjshëm në kuptim të nenit 525 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.1962/2025

Merlinda Ramaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, B.K;
- Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës: Drejtores së Përgjithshme dhe Udhëheqësit të Njesisë për Burime Njerëzore dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.